



Agjencioni për Financim në Kosovë (AFK) është Institucion i suksesshëm Mikrofinanciar që vepron në tërë Kosovën. Nëse dëshironi të jeni pjesë e një institucioni me integritet që vendos theks te veçantë në kujdesin ndaj klientit, dhe nëse plotësoni kriteret e pozitës së përshkruar më poshtë, ftoheni që të aplikoni për:

VENDE TË HAPURA PUNE

Pozita: Asistent Auditor i Brendshëm
Lokacioni: Peje/ Zyra Qëndrore
Kohëzgjatja: Kontratë njëvjeçare me mundësi vazhdimi
Data e fillimit: Menjëherë

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Siguron që aktivitetet e Institucionit Mikrofinanciar të jenë në harmoni me Statutin e IMF si dhe me të gjitha rregullativat ligjore;
- Mbikëqyrë dhe kontrollon zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit;
- Mbikëqyrë dhe kontrollon zbatimin e procedurave adekuate të kontrolleve të brendshme dhe të kontabilitetit duke i përfshirë edhe rregulloret dhe rregullat e BQK-së;
- Kryen kontrollat të brendshme sipas planit të Auditimit të Brendshëm të aprovuar më parë;
- Kryen kontrollat të veçanta të aktiviteteve të degëve, departamenteve dhe njësive të AFK-se;
- Mbledh, analizon dhe vlerëson të dhënat nga fushat e ndryshme të veprimtarisë së AFK-se me qëllim të arritjes së një vlerësimi objektiv;
- Përpilon raporte të shkruara dhe ia paraqet për aprovim udhëheqësit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm me qëllim të përcjelljes së më tutjeshme të tyre te përgjegjësit e degëve, departamenteve apo njësive të audituara;
- Për punët e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Departamentit;
- Përveç detyrave dhe përgjegjësisë të cekura përformon edhe në detyra tjera të kërkuara nga Mbikëqyrësi i Departamentit.

Kualifikimet:

- Fakulteti Ekonomik ose të ngjashme
 - Mbi 2 vite përvojë pune, preferohet përvojë në Auditim
 - Përparësi kanë kandidatët e certifikuar në lëmin e auditimit dhe kontabilitetit si në IKAF, SHKÇAK, ACCA, CPA apo ndonjë shoqatë tjetër;
 - Njohuri të gjuhës angleze;
 - Njohuri në kompjuter: world, excel etj.
- Te interesuarit mund ta shkarkojnë Aplikacionin për punësim nga web faqja zyrtare: www.afkonline.org

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit: recruitment.hr@afkonline.org

Afati i aplikimit është deri më datë 26 Mars, 2021 ora 16:00.

Vetëm kandidatët të cilët hyjnë në rrethin e ngushtë do të ftohen për procedura të më tutjeshme.